

# “SISTEMI I PUSHTETIT PARALEL I KOSOVËS 1990-1999”

TEMA PËR TITULLIN  
DOKTOR I SOCIOLOGJISË

NGA

FLORENT RRAHMANI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË

PRISHTINË  
NËNTOR, 2022

**REZYME E PUNIMIT TË DOKTORATËS**  
**“SISTEMI I PUSHTETIT PARALEL I KOSOVËS 1990-1999”**

Mentor: Akademik. Prof. Dr. Anton Berishaj

“Sistemi i pushtetit paralel i Kosovës 1990-1999”, është një temë që është trajtuar deri tani pjesërisht dhe më tepër në rrafshet tjera si në atë historik, politik, sesa në kontekstin sociologjik. Rezistenca civile, mosbindja politike, mosbindja qytetare, lindja e sistemit paralel, funksionimi i tij dhe projektimi i jetës sociale-kulturore dhe politike si një kronologji shoqërore e ndërtuar mbi fuqinë e vetorganizimit, me efekte të fuqishme sociale e politike – përbën boshtin tematik të kësaj teme të doktoratës.

Gjithë efekti i sistemit paralel në rrethana krejtësisht të jashtëzakonshme, duke synuar të zakonshmen, duke synuar funksionimin dhe funksionalizimin e jetës institucionale.

Natyrisht që zhvillimet paralele janë të shumta dhe të gjithanshme në këtë shoqëri, porse sistemi i pushtetit paralel i Kosovës 1990-1999, sikur hapi rrugët për shumë zhvillime të tjera për funksionimin paralel të vetë jetës, si dhe prodhoi mundësi e mendësi të reflektimit paralel.

Gjithë ky vetorganizim prodhon e imponon refleksion duke u bërë shtrat i sistemit paralel dhe themel i zhvillimeve të mëtutjeshme.

Ndërtimi i jetës mbi këtë themel është një temë që do trajtim dhe reflektim sociologjik, mbi çka edhe do të ndërtohet çdo hipotezë brenda kësaj sfere dhe brenda këtij punimi.

Risi në kuadër të kësaj teme vjen trajtimi i ndërtimit të vet sistemit paralel, ndërtimit i rezistencës civile, fuqizimi i mosbindjes politike, qytetare dhe ndërlidhja e faktorëve homogjenizues. Duke i trajtuar secilën veç e veç, por edhe duke i analizuar si tërësi veprimet e vetorganizimit, veprimet e kundërshtimit, të cilat kanë mundësuar dhe jetësuar vetë sistemin paralel.

Meqë rasti i Kosovës përbën një rast të veçantë të ndërtimit të një jete paralele sociale, kulturore, politike dhe arsimore, natyrshëm se është e një rëndësie të veçantë të shihet në detaje zhvillimi i tërë kësaj.

Një rrjet i tërë i vetorganizimit, në një dhe të vetmin qëllim: organizimin e jetës tashmë të shembur jo thjesht emocionalisht, sa edhe përmbajtësisht, përbënte funksionimin e luftës për mbijetesë, të mbijetesës politike, sociale, ekonomike e psikologjike, në një terren krejtësisht ushtarak e policor. Punimi me titull “Sistemi i pushtetit paralel i Kosovës 1990-1999” ka për synim të nxjerrë në pah se si është organizuar e vetorganizuar shoqëria në këtë periudhë kohore dhe se cili ka qenë kontributi i saj, në një periudhë kur mbyllja e institucioneve, largimet nga vendet e punës, ishin veprimet që rrezikuan në thelb vetë ekzistencën e shqiptarëve në Kosovë, dhe prodhuan një varg padrejtësish e diskriminimesh, të cilat imponuan edhe veprimet paralele, si: organizimi i mësimin në shtëpitë shkolla, organizimi në rrafshin shëndetësor etj.,

Megjithatë, siç edhe do dëshmohet në vijimësi të këtij studimi, do të shohim se fuqia vetorganizuese është ajo e cila përveçse ishte e paparashikueshme, po kështu prishi edhe teoritë e përmbysjes së jetës brenda kufijve dhe ndërtoi të gjitha parakushtet për mbijetesë. Kjo, praktikisht, prishi edhe politikën e spastrimit etnik të Kosovës dhe të gjitha ato politika për kolonizim, ngase pikërisht në ballafaqim me politika të tilla, shoqëria kosovare ndërtoi dhe fuqizoi sistemin paralel, ndërtoi dhe fuqizoi rezistencën civile duke e bërë atë realitet të njohur edhe në rrafshin ndërkombëtar, pikërisht nëpërmjet politikës së mos dhunës.

***Fjalët kyçe:*** Sistemi paralel, rezistenca civile, mosbindja politike, vetorganizimi social, shëndetësor, arsimor

## STRUKTURA E DISERTACIONIT

Struktura e disertacionit të doktoratës me titull “Sistemi i pushtetit paralel i Kosovës 1990-1999”, përveç pjesës hyrëse, përmban gjashtë kapituj, ka përfundimin, literaturën, rekomandimet si dhe aneksin e veçantë, në të cilin janë paraqitur intervista e realizuara.

Hyrja e studimit – Në këtë segment janë paraqitur çështjet kryesore të studimit, të cilat janë trajtuar në kuadër të këtij punimi. Gjithashtu, këtu janë përfshirë edhe qëllimi i studimit, specifikat, synimet, pyetjet hulumtuese, objektivat dhe metodologjia.

Kapitulli i parë – Ky kapitull fokusohet në ndryshimet kushtetuese të vitit 1989, të cilat imponojnë rezistencën civile dhe mosbindjen politike dhe qytetare, të cilat rezultojnë me sistemin paralel në Kosovë përgjatë një dekade të tërë. Po kështu, përfshin edhe aspektin teorik të rezistencave civile dhe mosbindjes politike e qytetare. Në kuadër të tij, po kështu hyn edhe nevoja për sistemin paralel, roli dhe funksionimi i tij, ndërlidhja ndërmjet sistemit paralel dhe rezistencës civile.

Kapitulli i dytë – Në kapitullin e dytë do të përqendrohemi në sistemin paralel dhe faktorët homogjenizues kombëtarë, përfshirë këtu edhe një sërë dukurish për të cilat janë bërë veprime konkrete dhe kanë rezultuar të suksesshme, siç ishte pajtimi i gjaqeve. Po kështu, është parë edhe ndërlidhja ndërmjet sistemit paralel dhe frymës vetorganizuese, sikur edhe format dhe mekanizmat homogjenizimit kombëtar, të cilët kanë mundur dhe jetësuar vetë sistemin e pushtetit paralel.

Kapitulli i tretë – Në kuadër të këtij kapitulli do të trajtohet sistemi paralel dhe vetorganizimi në rrafshin social, sa ka ndihmuar dhe kontribuar vetorganizimi në këtë fushë në drejtim të ndërtimit të sistemi paralel në përgjithësi. Po kështu, do të shihen edhe format e vetorganizimit social, të cilat rrjedhimisht kanë mundur edhe vetfunksionimin dhe mbijetesën sociale. Në kuadër të këtij kapitulli gjithashtu analizohen aksione, të cilat kanë qenë në shërbim të ruajtjes së mirëqenies sociale dhe që kanë pasur impakt të rëndësishëm në vetë sistemin paralel, si aksioni “Familja mban familjen”, Fondi i “Trepërqindëshit”, Këshilli Qendror për Financim i Kosovës dhe këshillave komunale për financim.

Kapitulli i katërt – Në këtë kapitull fokusimi ka qenë pikërisht në masat e dhunshme në sistemin shëndetësor dhe pasojat që kanë prodhuar ato me përjashtimin masiv nga vendet e punës të punëtorëve shëndetësorë shqiptarë. Në kuadër të tij, fokus të veçantë i kushtohet edhe pasojave në rrafshin shëndetësor dhe social që kanë prodhuar masat e dhunshme dhe nevoja për krijimin e

sistemit paralel dhe vetëfunksionimit në rrafshin shëndetësor. Gjithashtu, në kuadër të këtij kapitulli është trajtuar edhe vetorganizimi në rrafshin shëndetësor, sikurse edhe mbijetesë e tij.

Kapitulli i pestë – Në kuadër të këtij kapitulli janë trajtuar çështjet thelbësore që kanë të bëjnë me arsimin në Kosovë në vitet '90, duke nisur që nga ligjet diskriminuese, të cilat imponuan zbatimin e planprogrameve mësimore, që u kundërshtuan nga mësimdhënësit dhe nxënësit shqiptarë. Ky kundërshtim prodhoi një varg pasojash të mëpastajme deri në mbylljen e shkollave shqipe. Në fokus do jenë: sistemi paralel, vetorganizimi në rrafshin arsimor dhe mbijetesë e arsimit shqip.

Kapitulli i gjashtë – Në këtë kapitull, do të shihet se cila ishte ndërlidhja ndërmjet sistemit paralel dhe diasporës shqiptare, si dhe kontributi i kësaj të fundit në ruajtjen e mbijetesës dhe të ndërtimit dhe fuqizimit të sistemit paralel. Në pjesën e përfundimit përfshihen gjetjet nga studimi, rezultatet dhe rekomandimet, literatura dhe pjesa e shtojcës. Intervista e realizuar gjatë hulumtimit në terren.

**RESUME OF THE DOCTORAL THESIS**  
**“THE PARALLEL POWER SYSTEM OF KOSOVO 1990-1999”**

Mentor: Akademik. Prof. Dr. Anton Berishaj

“The parallel power system of Kosovo 1990-1999”, is a topic which so far has been addressed partially and rather on other levels like the historical and political level, than in the sociological context. Civil resistance, political disobedience, civil disobedience, the nascent of the parallel system, its functioning and the projection of social-cultural and political life as a social chronology built on the power of self-organization, with powerful social and political effects - constitutes the thematic axis of this doctoral thesis. The entire effect of the parallel system in completely extraordinary circumstances, aiming the ordinary, aiming the functioning and functionalization of institutional life. It is certain that parallel developments are numerous and versatile in this society, but the parallel power system of Kosovo 1990-1999, kind of opened the ways for many other developments for the parallel functioning of life itself, and also produced the possibility and mentality of parallel reflection. All this self-organization produces and imposes reflection, becoming the base of the parallel system and the foundation of further developments.

The building of life on this foundation is a topic that needs sociological treatment and reflection, on which every hypothesis, within this sphere and within this paper, will be built.

A novelty within this topic is the treatment of the building of the parallel system, the building of civil resistance, the empowerment of political and civil disobedience and the interconnection of homogenizing factors. Treating each one separately, but also analyzing as an entirety the actions of self-organization, the actions of opposition, which have enabled and brought to life the parallel system itself.

Since the case of Kosovo constitutes a special case of building a parallel social, cultural, political and educational life, it is of course of special importance to see the development of all this in detail.

A whole network of self-organization, with a one and only purpose: the organization of the already collapsed life, not only emotionally, but also substantively, constituted the functioning of the struggle for survival, of political, social, economic and psychological survival, in a completely military and police terrain.

The thesis entitled “The parallel powers system of Kosovo 1990-1999” aims to highlight how the society was organized and self-organized during this time period and what its contribution was, during a period when the closure of institutions, expulsion from workplaces, were the actions that essentially endangered the existence of Albanians in Kosovo, and produced a series of injustices and discriminations, which also imposed parallel actions, such as: the organization of studying in school homes, organization in the health field, etc.

However, as will be proven in the continuation of this study, we will see that the self-organizing power is the one which, apart from being unpredictable, also destroyed the theories of overturning life within the borders and built all the prerequisites for survival. This, in practice, also destroyed the policy of ethnic cleansing of Kosovo and all those policies for colonization, because exactly in the confrontation with such policies, the Kosovar society built and strengthened the parallel system, built and strengthened the civil resistance, making it a known reality even on the international level, precisely through the policy of non-violence.

**Key words:** Parallel system, civil resistance, political disobedience, social, healthcare, educational self-organization

## **STRUCTURE OF THE DISSERTATION**

The structure of the doctoral dissertation entitled “The parallel power system of Kosovo 1990-1999”, in addition to the introductory part, contains six chapters, has the conclusion, the literature, recommendations, and also the special annex, in which the conducted interviews are presented.

The introduction to the study - In this segment, the main issues of the study are presented, which have been addressed in the framework of this paper. Also, the purpose of the study, specifications, aims, research questions, objectives and methodology are included here.

The first chapter – This chapter focuses on the constitutional changes of 1989, which imposed civil resistance and political and civil disobedience, resulting in the parallel system in Kosovo for an entire decade. Likewise, it also includes the theoretical aspect of civil resistance and of political and civil disobedience. In its framework, falls also the need for the parallel system, its role and functioning, the connection between the parallel system and civil resistance.

The second chapter - In the second chapter we will focus on the parallel system and the national homogenizing factors, including a series of events for which concrete actions have been taken and have been successful, such as blood reconciliation. Likewise, the connection between the parallel system and the self-organizing spirit has been seen, as well as the forms and mechanisms of national homogenization, which have enabled and implemented the parallel power system itself.

The third chapter - In the framework of this chapter, the parallel system and self-organization on the social level will be treated, how much has self-organization helped and contributed in this field in terms of building the parallel system in general. Likewise, a look will be taken at the forms of social self-organization, which consequently have enabled social self-functioning and survival. In the framework of this chapter, actions are also analyzed, which have been in service of maintaining social welfare and which have had a significant impact on the parallel system itself, such as the action “The family supports the family (Familjambanfamiljen)”, the “Three percent” fund (Fondi i “Trepërqindëshit”), the Central Council for the Funding of Kosovo and municipal councils for funding.

The fourth chapter - In this chapter, the focus has been precisely on the violent measures in the healthcare system and the consequences they have produced with the mass exclusion of Albanian healthcare workers from their places of work. In its framework, a special focus is also given to the



health and social consequences the violent measures have produced and the need for the creation of a parallel system and self-functioning in the health field. Also, within this chapter, self-organization in the field of healthcare, as well as its survival, has been addressed.

The fifth chapter - Within this chapter, the essential issues related to education in Kosovo in the 90s have been addressed, starting from the discriminatory laws, which imposed the implementation of curricula, which were opposed by Albanian teachers and students. This opposition produced a series of subsequent consequences up to the closure of Albanian schools. The focus will be: the parallel system, self-organization in the educational field and the survival of Albanian education.

The sixth chapter - In this chapter, a look will be taken at what the connection between the parallel system and the Albanian diaspora was, and also at the latter's contribution in safeguarding the survival, building and strengthening the parallel system. In the conclusion part, the findings from the study, the results and recommendations, the literature and the part of the appendix are included. The interview conducted during field research.